

INFRASTRUKTURA/ PJESE TË RRJETIT

RRUGËT E PEDALIMIT

Vështrim

Një rrugë pedalimi është ajo rrugë e projektuar në mënyrë të atillë ku pedaluesit dominojnë vizualisht. Kjo rrugë ngjan si pistë e gjerë pedalimi që i kushtohet biçikletave, por lejon edhe trafikun e motorrizuar. Ligjërisht, rruga e pedalimit është një rrugë me trafik të përzier. Në zonat private mund të konsiderohet si rrugë kryesore lokale.

Sfondi dhe Objektivat

Funksioni

Një rrugë pedalimi është thjeshtë një vazhdim rruge e cilësisë së lartë e përdorur edhe nga trafikun i motorrizuar me intensitet të ulët. Ajo mund të konsiderohet si rruga kryesore që përshkon zonën e banimit për në hyrjet private.

Qëllimi

Rrugët e pedalimit duhet të konsiderohen si rrugë kryesore brenda zonave të ndërtuara (më shumë se 2000 pedalues / ditë) dhe me shpejtësi të ulët trafiku (më pak se 30 km / orë), ndërsa jashtë zonave të ndërtuara, ato mund të konsiderohen me shpejtësi deri 60 km / orë dhe intensiteti i trafikut është shumë i ulët (më poshtë se 500 PCU / ditë).

Në një rrugë pedalimi, përdoruesit e biçikletës duhet të dominojnë të gjithë fushëpamjen e rrugës dhe trafikun. Një rregull parësor është se duhet të ketë të paktën dy herë më shumë pedalues se sa makinat në një rrugë të këtillë.

Zbatimi

Përkufizimi

Në aspektin ligjor një rrugë pedalimi është një rrugë publike me trafik të përzier. Megjithatë, hartimi i saj favorizon pedaluesit në mënyrë që ajo të bëhet tërheqëse si një rrugë kryesore funksionale për biçikleta. Trafiku motorrik ka qasje, por projektimi qartëson praninë e tyre si të ftuar kalimtarë në një rrugë për biçikleta. Për ta bërë më tërheqëse një rrugë të tillë, duhet të ketë të drejtën e lëvizjes (kjo normalisht nuk është e mundur në rrugë hyrëse lokale).

Në Gjermani rrugët e pedalimit u prezantuan si një kategori më vehte në kodin e trafikut në vitin 1997 (Fahrradstrasse): trafiku i motorrizuar duhet të jetë nën 3000 CPU / ditë, e drejta e rrugës është e mundur dhe hapësira për trafikun e motorrizuar në pikat hyrëse dhe dalje duhet të mbahen në minimum¹.



Sinjalistika e rrugës së pedalimit e përdorur në Hollandë (burimi i imazhit: P. Kroeze)

¹ Forschungsgesellschaft für strassen- und verkehrswesen – 1995: Empfehlungen für Radverkehrsanlagen ERA 95



Rekomandimet kryesore të projektimit

Rrugët e pedalimit duhet, sipas përkufizimit, të krijojnë një përshtypje vizuale që i kushtohet kryesisht biçikletës. Ato i ngjajnë një piste pedalimi, pa qenë të tilla, ose si një korsi e këshilluar ku ndahet një pjesë e mirë e sipërfaqes së rrugës. Më poshtë janë disa parime të rekomanduara.

- Imponimi i kufirit të shpejtësisë prej 30 km / orë - ky është një kusht thelbësor
- Sigurimi i së drejtës-së-kalimit për rrugët e pedalimit edhe në udhëkryqe
- Përdorimi i një sipërfaqeje me shtresë kompakte, mundësisht asfalt, për rehati
- Mundësisht të përdoret një ngjyrë dalluese
- Plotësimi i pjesëve tranzite mes korsive të pedalimit dhe pjesës tjetër të karrexhatës
- Sigurimi një forme për udhëzime fizike ku të bëhen zgjedhjet për mirëkuptimin dhe rehatinë
- Minimizimi i pengesave apo kërcënimeve të shaktuara nga automjetet e parkuara, për rehati dhe siguri
- Të mos lejohet parkimi në karrexhatë

Mundësitë e planit të rrugës

Mund të dallohen² tre zgjidhje të rrugës. Në përgjithësi ato mund të aplikohen në një rrugë dy-drejtimëshe, ekzistuese dhe e ngushtë, duke zëvendësuar dy korsitë e trafikut me një nga projektimet e mëposhtme. Përmasat duhet të të mjaftueshme sa për të lejuar lëvizje të mirë për një numër të madh pedaluesish.

Çdo lloj zgjidhje mund të përshtatet për trafikun e motorrizuar me një ose dy-drejtime. Nëse kombinohen pedaluesit me trafikun sipas një drejtimi do të rritet kapaciteti për trafik të motorrizuar: trafiku me dy-drejtime është i mundur deri në 500 PCU / ditë, trafiku një-drejtimësh deri në 2000 PCU /ditë.

Rrugët e pedalimit mund të kombinohen me korsi dhe gjire parkimi.

	Rrugë pedalimi me trafik të përzier	Rrugë pedalimi me pedalues në anë	Rrugë pedalimi me pedalues në mes
Parimi	E gjithë karrexhata është e ngjyrosur që të ngjajë si një pistë pedalimi	Pedaluesit lëvizin në dy korsi të këshilluara pedalimi, duke lënë një rrugë qendrore për trafikun	Pedaluesit lëvizin në një korsi qendrore pedalimi dhe dy rripa që kufizojnë makinat të kalojnë
Përmasat e rekomanduara	4.5 m për të gjithë rrugën e trafikut (hapësirë 2x2 për përmasat e pedaluesve)	2 m për secilën korsi pedalimi Max. 3.5 m për rrugë trafiku qendrore	4.5 për karrexhatë 3 m për rrugë qendrore trafiku 0.75 m për çdo rrip kufitar
Shtrimi	Shtresa e ngjyrosur për 'biçikleta' kalon karrexhatën	Shtresë e ngjyrosur për korsi të këshilluar pedalimi	Shtresë e ngjyrosur për korsi të këshilluar pedalimi Rrip kufitar me element shtrese të zezë/gri

² CROW – 2006: Design manual for bicycle traffic in The Netherlands. CROW-record 25



Rrugë pedalimi, projekte të ndryshme (burimi i imazhit: P. Kroeze)

Konsiderata

Pikat e forta

Për pedalesin, rrugët e pedalimit janë thuajse aq të sigurta, tërheqëse, të rehatshme dhe direkte aq sa edhe pistat e pedalimit. Ndryshimi i vetëm është se ndërsa projektimi favorizon bicikletën, një numër i vogël makinash përdorin rrugën e pedalimit me shpejtësi të ulët, për të hyrë në pronat e tyre, përderisa kjo rrugë përshkon blloqet e banimit. Siguria gjithashtu është e lartë.

Rrugët e pedalimit janë rrugë kryesore të dukshme, që i bën të krahasueshme në sytë e drejtuesve të automjeteve duke rritur sigurinë. Si rrjedhojë, pedalimi bëhet shumë i pranishëm në projektimin urban.

Një rrugë pedalimi është një hapësirë e shfrytëzuar më e vogël se sa një pistë pedalimi (e ndarë nga karrexhata). Për këtë arsye mund të jetë më efektive por më e kushtueshme.

Një rrugë pedalimi ka përparësinë në mënyrën se si qaset nga trafiku i motorrizuar, duke përfshirë hapësirën e parkimit. Një pistë pedalimi është e paqasshme për trafikun e motorrizuar, ose detyron reduktimin e hapësirës së parkimit.

Pikat e dobëta

Rrugët e pedalimit mund të jenë mjaft tërheqëse për drejtuesit e mjeteve, lidhur me përparësinë në lëvizje dhe nëse kjo përparësi vazhdon. Masa shtesë mund të jenë të nevojshme: alternimi i trafikut një-drejtëmësh, ulja e shpejtësisë etj.

Mundësitë alternative

Në rastin e një numri të vogël pedalesish, zgjidhje e thjeshtë mund të jetë përzjerja e trafikut, me masat e mundshme të QETËSUESVE TË TRAFIKUT.

Në një rrugë pedalimi me më shumë intensitet dhe trafik më të shpejtë, pedalesit duhet të ndahen nga trafiku në PISTAT E PEDALIMIT.